



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 86, dt.13.04.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr. 75, dt.03.04.2015, “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” në mbledhjen e datës 13.04.2016, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për shoqërinë e ndërtimit “MET –ENGINEERING” sh.p.k, me drejtues teknik restaurator *ing. Fatjon Saliu*, i pajisur me licensë personale profesionale në zbatim, R.P. 58, me nënkategoritë AZ/3, AZ/4,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “MET –ENGINEERING” sh.p.k, me drejtues ligjor z. *Gazmend Metohu* për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për kategorinë:  
**CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.**
  2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “MET –ENGINEERING” sh.p.k, për kategorinë:  
**CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik restaurator *ing. Fatjon Saliu (R.P.58)*.**
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI